



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	178
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	20.07.2017
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademiya Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/178/2017
Datë: 18/07/2017

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë në bazë të nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenit 11 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e katërt të përbërjes së parë, të mbajtur më 18 korrik 2017, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja Nr. 04/2017 për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues.



Aleksandër Lumezi

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë / Akademia Pravde / Academy of Justice

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, lidhur me nenin 17 paragrafi 1, nën paragrafi 1.10 i Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur me datë 18.07.2017,

Miraton:

RREGULLORE NR. 04/2017
PËR PUNËN E KËSHILLIT PROGRAMOR TË AKADEMISË SË DREJTËSISË

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë mënyrën, organizimin e punës dhe funksionimin e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli Programor).

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për Akademinë e Drejtësisë, Këshillin Programor dhe organet tjera të Akademisë sipas qëllimeve të përcaktuara me këtë Rregullore.

Neni 3
Parimet bazë të punës së Këshillit Programor

Këshilli Programor në punën e tij udhëhiqet nga parimet e pavarësisë, profesionalizmit dhe transparencës.

Neni 4 **Gjuha e punës**

Gjuhë e punës së Këshillit Programor është gjuha shqipe dhe gjuha serbe.

Neni 5 **Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Programor**

1. Këshilli Programor ka kompetencat si në vijim:
 - 1.1 Harton propozim programin e trajnimeve të Akademisë në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
 - 1.2 Përcjell realizimin e programeve dhe suksesin e tyre;
 - 1.3 Jep orientime për avancimin e metodave dhe teknikave trajnuese, pavarësisht dhe në bashkëpunim me trajnuesit dhe mentorët;
 - 1.4 Jep mendim, për listën e trajnuesve dhe mentorëve;
 - 1.5 Jep këshilla, propozime dhe sugjerime, organeve të Akademisë për përmirësimin e kualitetit të trajnimeve;
 - 1.6 Kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore të Akademisë.

Neni 6 **Përbërja e Këshillit Programor**

1. Këshilli Programor përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, të cilët i emëron Këshilli Drejtues, nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve të shtetit dhe ekspertëve tjerë;
2. Drejtori i Akademisë është ex officio anëtar dhe Kryesues i Këshillit Programor.
3. Mandati dhe pushimi i funksionit të anëtarëve të Këshillit Programor janë të përcaktuara me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë.

Neni 7 **Kompetencat e Kryesuesit të Këshillit Programor**

1. Kryesuesi i Këshillit Programor ka kompetencat si në vijim:
 - 1.1 Përfaqëson Këshillin Programor në institucionet vendore dhe ndërkombëtare;
 - 1.2 Kujdeset për organizimin dhe menaxhimin e punës së Këshillit Programor;
 - 1.3 Thërret dhe kryeson mbledhjet e Këshillit Programor;
 - 1.4 Propozon rendin e ditës;
 - 1.5 Udhëheq punën e Këshillit Programor;
 - 1.6 Përcjellë në Këshillin Drejtues të Akademisë së Drejtësisë propozimet e Këshillit Programor.
 - 1.7 Kryen punë dhe detyra të tjera të caktuara me Ligjin e Akademisë, me këtë rregullore dhe me dispozita tjera ligjore.

Neni 8

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Këshillit Programor

1. Anëtarët e Këshillit Programor kanë të drejta dhe detyra si në vijim:
 - 1.1. Marrin pjesë në takimet e Këshillit Programor, përveç kur e arsyetojnë mungesën, me ç 'rast janë të detyruar që paraprakisht ta njoftojnë Kryesuesin e Këshillit;
 - 1.2. Marrin pjesë në hartimin, propozimin dhe përditësimin e programit të trajnimeve të Akademisë;
 - 1.3. Përcjellin zbatimin programeve trajnuese, suksesin e tyre dhe japin mendim për listën e trajnuesve dhe mentorëve;
 - 1.4. Japin orientime për zhvillimin e metodologjisë trajnuese, pavarësisht dhe në bashkëpunim me trajnuesit dhe mentorët;
 - 1.5. Këshillojnë organet e Akademisë për përmirësimin e kualitetit të trajnimeve;
 - 1.6. Kompensohen me shumën e përcaktuar sipas ligjit për Akademinë;
 - 1.7. Kryejnë edhe punë tjera të përcaktuara me Ligjin dhe aktet nënligjore të Akademisë së Drejtësisë.

Neni 9

Mbështetja administrative teknike

Stafi i Akademisë ofron mbështetje teknike dhe administrative Këshillit Programor.

Neni 10

Takimet e Këshillit Programor

1. Këshilli Programor kryen detyrat dhe përgjegjësitë e tij në takime të cilat mbahen së paku katër (4) herë në vit.
2. Takimet e Këshillit Programor mbahen vetëm nëse janë të pranishëm së paku 5 anëtarë.
3. Këshilli Programor sipas nevojës për të përditësuar dhe siguruar cilësinë e trajnimeve të ofruara nga Akademia e Drejtësisë mund të takohen edhe më shpesh.

Neni 11

Njoftimi dhe rrjedha takimit të Këshillit Programor

1. Takimet e Këshillit Programor i thërret Kryesuesi;
2. Njoftimi për takimin iu dërgohet me postë elektronike (e-mail) ose shkresë të dërguar përmes Zyrës së Drejtorit, së paku pesë (5) ditë pune para takimit;
3. Kryesuesi e kryeson takimin e Këshillit dhe njofton për anëtarët të cilët kanë paralajmëruar dhe arsyetuar mungesën;
4. Anëtari i cili mungon mund t'i dërgoj rekomandimet e tij me shkrim për çështje të caktuara sipas detyrave dhe përgjegjësi;
5. Varësisht nga rendi i ditës, përveç anëtarëve të Këshillit Programor mund të marrin pjesë edhe stafi i Akademisë së Drejtësisë.

Neni 12
Procesverbali i takimit

1. Për punën e Këshillit Programor, në takim mbahet procesverbali.
2. Procesverbalin e mbanë zyrtari kompetent i caktuar nga Kryesuesi.
3. Procesverbali përmban të dhënat themelore të takimit, dhe atë: ditën dhe vendin e mbajtjes e takimit, numrin e takimit, pjesëmarrësit, rendin e përcaktuar të ditës, emrat e paraqitësve dhe pjesëmarrësve në diskutim si dhe rekomandimet për çështjet që trajtohen.
4. Mbledhjet e Këshillit mund të incizohen audio nga zyrtari kompetent.
5. Procesverbali u dërgohet të gjithë anëtarëve për komente para finalizimit.
6. Procesverbali ruhet në Arkivin e Akademisë.

Neni 13
Raportimi

Këshilli Programor për punën e tij i raporton Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë së paku një (1) herë në vit dhe sipas kërkesës.

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 14
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohen të gjitha dispozitat tjera nënligjore që rregullojnë punën dhe funksionimin e Këshillit Programor.

Neni 15
Ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores

Kjo Rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet sipas mënyrës së nxjerrjes së saj.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues.

Prishtinë, 18.07.2017



Aleksandër Lumezi

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë